**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada - Government***
***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës***
***Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture***
***Ministry Of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***

# KONTRATË

Numri i kontratës[1]: **210-24-958-2-2-1/C256**

**Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

**GIS Data Project SH.P.K., Prishtinë, Pristine, 812075689,** (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

**Shenjezimi dhe digjitalizimi i zonave te mbrojtura te natyres** me numër identifikues: **210-24-958-2-2-1 dhe nr. te brendshëm MMPHI 205 24 005 221.**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve: **Shenjezimi dhe digjitalizimi i zonave te mbrojtura te natyrës. Ekzekutimi I kontratës do te behet ne baze te specifikimit teknik te përcaktuar ne FDT. Pjesë e kontratës është edhe oferta me çmime e dorëzuar nga OE.**

| Përshkrimi | Njësia matëse | Sasia | Çmimi për njësi Pa TVSH € | TVSH (%) | Çmimi për njësi ME TVSH € | ÇMIMI TOTAL ME TVSH € |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Tabela informuese për shenjëzimin e monumenteve të natyrës me dimensione 60x40 cm | copë | 60 | 91.50 | 16.47 | 107.97 | 6478.20 |
| Vendosja e tabelave në teren do të bëhet sipas lokacionit që caktohet nga zyrtaret e IKMN | copë | 60 | 55.00 | 9.90 | 64.90 | 3894.00 |
| Përgaditja dhe dizajnimi i tabelave informuese do të bëhet sipas Raportit të Grupit Punues i themeluar me Vendimin nr 388/2023 AMMK të datës 27.01.2023- *(Raporti i GP për përgatitjen e Shenjës (tabelës) informuese për shenjëzimin e Monumenteve të Natyrës (forma, madhësia dhe* | copë | 60 | 5.00 | 0.50 | 5.50 | 330.00 |

[1] Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

T. G.

N. M.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *përmbajtja).* | | | | | | |
| Operatori ekonomik duhet të marr përsiper që në rast të demtimit apo shlyerjes se tabelave informuese dhe ngjyrave në terene nga kushtet klimatike duhet të marr përsiper që pas vendosjes deri në dy vite ti rregulloj. | copë | 20 | 10.00 | 1.80 | 11.80 | 236.00 |
| Operatori ekonomik duhet të marr përsiper që në rast të demtimit apo shlyerjes se tabelave informuese dhe ngjyrave në terene nga kushtet klimatike duhet të marr përsiper që pas vendosjes deri në dy vite ti rregulloj. | copë | 60 | 20.00 | 3.60 | 23.60 | 1416.00 |
| | | | | | | 12354.20 |

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **12,354.20** €; dymbdhjetmijeetreqindepesedhjetekater Euro 20 cent.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

(d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit te Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

T.Q.



A.M.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqip në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

**Për Autoritetin Kontraktues**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | **Ndriçim Mustafa** |
| **Pozita:** | Zyrtar përgjegjës i prokurimit |
| **Nënshkrimi:** | [signature] |
| **Data:** | 04.04. |
| **Vula:** | [stamp: Republika e Kosovës] |

**Për Ofruesin e Shërbimeve**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | Tomor Gela |
| **Pozita:** | Menaxher |
| **Nënshkrimi:** | [signature] |
| **Data:** | 04/04/2024 |
| **Vula:** | [stamp] |

T.G

N.M